

A JENI VIKTIMË E DHUNËS NË FAMILJE? MUND TË KËRKONI NDIHMË!

*Çka mund të bëjnë Policia, Mbrojtësit e Viktimave,
Prokurorët dhe Gjyqtarët për t'i mbrojtur të drejtat e juaja si
viktimë e dhunës në familje .*

JU KENI TË DREJTË:

- Të trajtoheni me dinjitet.
- Të mbroheni nga kryesi i dhunës në familje.
- Të kërkonti një urdhër mbrojtje nga gjykata për t'iu mbrojtur nga kryesi i dhunës në familje.
- Të informoheni lidhur me procedurat ligjore.
- Të këshilloheni me prokurorin në lidhje me rastin tuaj.
- Të siguronit prova dhe fakte për incidentin përgjatë tërë procesit.
- Të njoftoheni për vendin dhe kohën e mbajtjes së seancës gjyqësore
- Të shprehni mendimin tuaj në gjykatë me rastin e caktimit të liritimit apo dënimit të kryesit të dhunës.
- Për t'u njoftuar në lidhje me lëshimin e urdhrin të mbrojtjes apo rezultatin e gjykimit penal.
- Për të marrë kompenzim nga kryesi i dhunës në familje.



POLICIA mund të:

- Lëshojë një urdhër mbrojtje të përkohshëm emergjent që e ndalon kryesin e dhunës t'iu afrohet për t'iu shqetësuar juve ose fëmijët tuaj
- Largojë kryesin e dhunës nga banesa/shtëpia si masë mbrojtëse.
- Informojë për shërbimet ligjore, psikologjike dhe shërbime tjera ekzistuese.
- Ndhimjnë në gjetjen e një vendi të sigurtë.
- Ndhimjnë juve dhe fëmijëve tuaj që të merrni kujdes mjekësor nëse jeni lënduar.
- Ndhimjnë në marrjen e gjësendeve personale nga shtëpia juaj.
- Sigurojnë kontaktin me mbrojtësit e viktimave dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve.
- Sigurojnë kontaktin zyrtar me nënpunësin hetues të policisë nëse ka nevojë për ndihmë të mëtutjeshme.
- Informojnë lidhur me atë se si gjykata mund t'iu mbrojë nga dhuna.
- Sigurojnë me informata të përditësuar lidhur me statusin e hetimeve, përfshirë edhe informatat për kryesin e dhunës apo edhe lirimin e tij.

MBROJTËSIT E VIKTIMAVE mund të:

- Ju informojnë për të drejtat tuaja dhe t'i kuptoni ato.
- Ju informojnë për të drejtën tuaj që të kërkonit urdhër mbrojtje dhe mund t'iu ndihmojnë që ta përpiloni dhe ta dorëzoni kërkesën për urdhër mbrojtje.
- Ju shpjegojnë procedurat e përfshira në ndjekjen e rastit dhe rolin tuaj në këto procedura.
- Të bashkëpunojnë me policinë, prokurorin dhe gjykatësit për t'iu mbrojtur sa më mirë të drejtat tuaja si viktimë.
- Ju informojnë me zhvillimet e fundit në statusin e rastit tuaj.
- Ju informojnë në drejtën tuaj për kompenzim.

- Ju përfaqësojnë në procesin gjyqësor gjatë gjithë kohës.
- Ju sigurojnë një numër telefoni ku mund të raportoni informata shpesh lidhur me rastin.
- T'iu ndihmojnë në përgatitjen e planeve të sigurisë për ju dhe fëmijët tuaj nëse kryerësi i dhunës ju kërcënon, frikëson apo ju shqetëson juve.
- Ju sigurojnë një listë të shërbimeve ekzistuese në komunitet: për siguri, për t'iu përmbushur nevojat kryesore dhe shërbimeve tjera përfituese.

PROKURORËT mund të:

- Ju mbrojnë, të forcojnë dhe të sigurojnë mbrojtjen e të drejtave të viktimave.
- Ju informojnë me terma të thjeshtë rrjedhën e procedurës gjyqësore.
- Ju përfshijnë informata rreth ndikimit të krimit tek viktima dhe të ju ndihmojnë në mbledhjen e fakteve dhe dëshmimeve për rastin për t'iu prezentuar ato në procedurat gjyqësore.
- Ju informojnë për mundësinë e kompensimit si opcion i dënimit nga gjykata.
- Ju njoftojnë për vendimet e gjykatës që janë marrë lidhur me rastin.

GJYKATAT mund të:

- Lëshojnë urdhra të mbrojtjes apo urdhër mbrojtje emergjente për ju dhe fëmijët tuaj.
- Përmes urdhrit për mbrojtje gjykata mund të urdhërojë që kujdestaria e fëmijës përkohësisht t'iu besohet viktimës.
- Të sigurojnë se viktimat dhe dëshmitarët janë të informuar plotësisht lidhur me procedurat gjyqësore dhe mbajtjen e seancave.
- Të lejojnë pjesëmarrjen e viktimës në të gjitha fazat e proceseve gjyqësore.

- Të dënojnë kryesin e dhunës për veprën penale të dhunës në familje.
- Të mbrojnë viktimat dhe dëshmitarët nga ngacmimi, kërcënimi, frikësimi dhe lëndimi duke i kufizuar qasjen në të dhënat personale të viktimave dhe dëshmitarëve.

Në mënyrë që t'i mbroni sa më mirë interesat dhe të drejtat tua në procedurat gjyqësore është shumë me rëndësi që të bashkëpunoni me:

Policinë

për të raportuar rastin e dhunës familjare, për të kërkuar mbrojtje dhe për t'iu ndihmuar që të kontaktoni Mbrojtësin e Viktimave dhe Prokurorin.

Mbrojtësit e Viktimave

që të ju ndihmojnë që t'i kuptoni të drejtat tuaja; të ju ndihmojnë që të parashtroni kërkesën për urdhër mbrojtje dhe të punoni bashkarisht me prokurorin për t'iu ndihmuar në procedurat gjyqësore përfshirë edhe marrjen e kompenzimit.

Prokurorët

për t'iu këshilluar lidhur me rastin tuaj; për të bashkëpunuar në mbledhjen e provave; për të përkrahur ndikimin e krimit tek ju në mënyrë që të mirret parasysh nga gjykata në përcaktimin e dënimit

Në rastet emergjente kërkoni ndihmë:

Telefoni policinë në 92 ose 192 dhe raportoni rastin e dhunës në familje apo

Telefoni falas në linjen e ndihmës 0800 11 112 që të raportoni dhunën në familje dhe të merrni informatat për numrat e nevojshëm.